

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

"ROZAFA" SH.P.K.

09-Prill-21

Përgatiti: LOERMA SH.P.K.

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE.

Sfond.

Subjekti kërkues “ROZAFÄ” sh.p.k.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emër subjekti “ROZAFÄ” sh.p.k. është themeluar me datë 05.01.2006, është regjistruar më datë 05.01.2006 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me numër unik identifikimi të subjektit (NIPT) K48130547V.

Objekti i veprimtarisë së subjektit “ROZAFÄ” sh.p.k. është: *“Rikuperimi i mbetjeve jo të rrezikshme”*.

Administratori i këtij subjekti është znj. Lisiena METOSHI me afat emërimi nga: 02.07.2018 deri 02.07.2023.

Zyrat qendrore të shoqërisë “ROZAFÄ” sh.p.k., janë në adresën Tiranë, Tiranë, TIRANË, Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla 2, Ap. Nr. 3, Zona kadastrale 8150.

Subjekti “ROZAFÄ” sh.p.k. ka disa kohë që ka nisur punimet për ngritjen dhe vënien në shfrytëzim të një linje teknologjike, të rikuperimit të mbetjeve teknologjike që dalin gjatë përpunimit të peshkut, karkalecit të detiti, etj. në linjat teknologjike të këtij subjekti në Elbasan, Gramsh etj.

Shpjegim i termave të përdorura në këtë dokument.

Për shpjegimin e termave të përdorura ju kemi referuar Nenit 3 “Përkufizime” të Ligjit Nr. 156 datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve.”

“Dokument transferimi” është dokumenti që shoqëron çdo transfertë të mbetjeve të parrezikshme, sipas nenit 20 të këtij ligji.

“Krijues i mbetjeve” është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

“Mbetje e ngurtë” është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t’i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

“Mbetje bio” janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringut dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

“Mbetje jo të rrezikshme” janë mbetjet që nuk mbulohen nga përkufizimi i “mbetjeve të rrezikshme”.

“Mbetje të ambalazheve” janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes në këtë ligj, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.

“Parandalimi” janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:

- a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;
- b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;
- c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

“Rikuperimi” është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:

- a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;
- b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.

“Riciklimi” është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, **si për qëllimin fillestar**, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.

“Ruajtje e përkohshme” është mbajtja në një vend, me qëllim ruajtjen e mbetjeve për një periudhë kohe jo më shumë se një vit, pa kryer operacione që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së mbetjeve.

“Vendndodhja e mbetjeve” është vendi ku ndodhet lëndfilli apo incineratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.

“Zotërues i mbetjeve” është krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje.

“Rajon” është një ose disa njësi të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.

I. Instalimi dhe aktivitetet e tij.

Në vendin tonë teknologjia e përpunimit të mbetjeve teknologjike që dalin si rezultat i përpunimit të peshkut, karkalecit dhe prodhimeve të tjera të detit është pothuajse e pa njohur dhe për rrjedhojë mund të pohojmë se mungojnë investimet për ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të linjave teknologjike të riciklimit dhe/ose rikuperimit të këtyre mbetjeve teknologjike.

Në ditët e sotme nuk është e vështirë të gjesh linja teknologjike të kësaj natyre dhe të investosh për instalimin e tyre siç është edhe rasti konkret me Subjektin ROZAFa sh.p.k. Kështu, duke investuar në këtë fushë, ky subjekt trajton dhe zgjidh një problem mjedisor të vlerësuar, atë të mirëadministrimit të mbetjeve teknologjike të gjeneruar nga veprimtaria e linjave teknologjike të përpunimit të peshkut e karkalecit të detit në Elbasan, Gramsh etj.



Dhe duke marrë parasysh konkurrencën e vogël në këtë fushë, kjo do ti lejojë investitorit të krijojë shpejt një biznes fitimprurës.

E rëndësishme është që me vënien në efikasitet të kësaj linje teknologjike, duhet të rriten përpjekjet për gjetjen e lëndëve të para të nevojshme për këtë lloj produkti.

Linja e plotë e prodhimit të miellit të peshkut është e pajisur me makineritë e mëposhtme:

- Bunkeri pritës për lëndën e parë, (mbetje të peshkut, karkalecit etj.)
- Shneku transportues i mbyllur.
- Mikseri dhe heqësi i ujërave sipërfaqësore dhe yndyrës.
- Pajisja e tharjes dhe e heqjes së yndyrnave.
- Makina e seleksionimit sipas ganave dhe e mbushjes së thasëve të transportit.

Procesi i prodhimit është jashtëzakonisht i thjeshtë, në sajë të pajisjeve plotësisht të automatizuara, të instaluara në këtë linjë teknologjike. Kjo linjë teknologjike përdor energji elektrike dhe avull, të prodhuara nga kladaja përkatëse e cila punon me GLN.

Sa i përket procesit të prodhimit të miellit të peshkut, të gjitha fazat operationale në përbërje të procesit teknologjik, përmblihen në pikat e mëposhtme:

- Lëndët e para pastrohen nga një shumëllojshmëri mbeturinash dhe, papastërtitë shoqëruese të tyre.
- Zhvillohet procesi i bluarjes/coptimit.
- Kryhet procesi i zjerjes, të masës së përzjerë.
- Bëhet dehidratimi dhe tharja e ngarkesës
- Bëhet bluarja në formë mielli e të gjithë ngarkesës..
- Bëhet futja në thasë liri dhe vendosja e tyre në paletat e drurit.
- E gjithë ngarkesa shkon në magazinën e produktit të gatshëm për treg.

Lënda e parë , (mbetje të peshkut, karkalecit etj.) që gjendet në fuçi plastike 30-50 kg, ngarkohet në bunkerin metalik pritës për lëndën e parë. Me anë të shneku transportues të mbyllur ajo shkon në pajisjet teknologjike respektive, mikserin dhe pajisjen kryesore teknologjike.

Kur masa bëhet homogjene, ajo transferohet me anë të një pompe në bllokun e tharjes, ku qëndron 1,0-1,5 orë. Gjatë kësaj kohe, masa avullohet, pastaj mikser-avulli ndalohet, uji dhe yndyra e lëshuar prej tij filtrohen. Faza e fundit është tharja e produktit në një përmbajtje lagështie prej 9-10%.

Më tej kjo masë miell peshku e përgatitur shkon në makinën e seleksionimit sipas ganave dhe të mbushjes së thasëve të transportit.

Thasët e mbushur me peshë 30 - 50 kg, vendosen mbi paleta druri, me anë të të cilave ato transportohen në magazinën e produktit të gatshëm.

Linja teknologjike e prodhimit të miellit të peshkut, për treg ka një kapacitet mesatar prej 5 ton/ditë.

Miell peshku - një nga përbërësit më të vlefshëm (dhe për këtë arsye të shtrenjtë) në çdo ushqim të përbërë për bagëtinë dhe shpendët. Pluhuri i marrë gjatë përpunimit përzihet me pjesën më të madhe të ushqimit për t'i dhënë asaj veti të veçanta ushqyese.

Përbërja e miellit të peshkut është si më poshtë:

- proteina,
- acide yndyrore të pangopura,
- vitamina,
- elementët gjurmë.

Mielli i peshkut nuk ka kërkesa të rrepta për ruajtjen e tij. Magazinat ku ai qëndron në ruajtje deri në gjetjen e një tregu të përshtatshëm duhet të kenë ventilim të mjaftueshëm. Njëkohësisht duhet të tregohet kujdes në ruajtjen e niveleve të përshtatshme të temperaturës dhe lagështisë.

Por treguesve në magazinën e produktit të përfunduar duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë, pasi që kur mielli ruhet në kushte të papërshtatshme, ai mund të humbasë vetitë dhe paraqitjen e tij.

II. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

Për prodhimin e miellit të peshkut do të përpunohet si lëndë e para mbetjet teknologjike që gjenerohen gjatë proceseve të pastrimit të peshqëve, karkalecave, etj. të llojeve të ndryshme, që vijnë nga linjat teknologjike të Elbasanit, Gramshit etj. në përbërje të tyre mund të jenë kufoma e tërë, kocka, lëkura, koka, etj.

Linja teknologjike e prodhimit të miellit të peshkut kërkon energji elektrike ujë dhe avull.

➤ Energjia elektrike.

Objekti është i lidhur me rrjetin energjistik të Njësisë Administrative Labinot Fushë, në bazë të kontratës me operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike të kësaj zone. Subjekti ka të instaluar një gabinë elektrike me fuqi rreth 150 kWh, me anë të së cilës rregullon të gjithë parametrat e energjisë elektrike që shkojnë tek pajisjet e instaluara, sistemet e ndriçimit të ambienteve të brendshme të punës, të ambienteve të jashtëm rrugë e sheshe, etj.

Godina ku do ushtrohet veprimtaria prodhuese dhe të gjitha ambientet e saj janë duke u pajisur me të gjitha pajisjet e përcaktuara në projektin elektrik të tyre duke filluar nga sasia dhe llojet e përcjellësave elektrikë, pajisjet për vënien në punë dhe ndalimin nga puna të pajisjeve të ndryshme, pajisjeve ndriçuese, etj. Sistemi i shpërndarjes së rrymës elektrike ka pajisjet

mbrojtëse, ato sinjalizuese, të tokëzimit si dhe pajisjet matëse të konsumit të energjisë elektrike. Fuqia elektrike e instaluar do të jetë rreth 35 kWh.

➤ Uji.

Uji do të merret nga rrjeti përkatës i Njesisë Administrative Labinot Fushë, mbështetur në kontratën respektive me subjektin që administron këtë rrjet ujësjellës. Në hyrje të objektit është instaluar pajisja matëse e konsumit të ujit. Për sigurimin e ujit pandërerje është vendosur një depozitë metalike me vëllim 10 m³. Shpërndarja e ujit në pikat e përdorimit të tij do të bëhet nëpërmjet pompave dhe rrjetit përkatës me tuba plastike, që kalon i gjithë nëntokë. Edhe ky rrjet është i plotësuar me atrecaturat e përcaktuara në projektin përkatës të furnizimit dhe të shpërndarjes së ujit.

Në këtë aktivitet, uji nuk përdoret vetëm për plotësimin e nevojave humane të personelit punonjës prej rreth 5 personash. Uji do përdoret edhe për pastrimin e pajisjeve, ambienteve të punës, etj. Konsumi i ujit të pijshëm do të jetë rreth 15 m³/muaj.

➤ GLN (propan + butan).

GLN (propan + butan), përdoret për vënien në punë të kaldajës e cila prodhon avull në temperaturë 115 – 120 °C. Kaldaja punon në mënyrë të automatizuar duke ruajtur një regjim të krijimit të avullit, në sasi të kondicionuara nga konsumi i tij në pajisjen kryesore teknologjike të prodhimit të miellit të peshkut. G.L.N. vjen me automjetet e përshtashëm për mbajtjen dhe transportin e tyre dhe depozitohet në rezervuarin përkatës. Subjekti do të konsumojë rreth 2 m³/muaj G.L.N.



➤ Karburante (naftë & benzinë).

Nafta dhe benzina shërben për punën e mjeteve të transportit të brendëshëm dhe të atij jashtë subjektit. Konsumi i karburatit nga këto mjete pritet të jetë rreth 250 litra në muaj.

III. Burimet e shkarkimeve nga instalimi.

Nga zhvillimi i kësaj veprimtarije, të prodhimit të miellit të peshkut, priten të jenë këto shkarkime ndotësisht në atmosferë:

3.1. Shkarkime të gazeve dhe aromave në ajër, të cilat janë rezultat i punës së kaldajës për prodhimin e avullit që përdoret gjatë kryerjes së porceseve të ndryshme teknologjike.

3.2. Shkarkimet e ujërave të ndotur që do të dalin :

- gjatë procesve të përpunimit të lëndës së parë për prodhimin e miellit të peshkut
- gjatë larjes së pajisjeve dhe ambienteve të punës.

Njëkohësisht do të kemi edhe shkarkimet e ujërave të zeza.

3.3. Nga literatura teknike përkatëse nuk rezulton që linjat e përpunimit të mbetjeve të peshkut, karkalecit, etj. për prodhimin e miellit të peshkut, të mund të gjenerojnë mbetje teknologjike të ngurta.

Do të ketë gjenerim të mbetjeve të ngurta urbane.

IV. Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes.

Objekti në të cilën do të zhvillohet veprimtaria e rikuperimit dhe/ose riciklimit të mbetjeve teknologjike që dalin gjatë përpunimit të peshkut, karkalecit dhe prodhimeve të tjera të detit, gjendet në fshatin Mengël, të Njësisë Administrative Labinot Fushë të Bashkisë Elbasan. Objekti gjendet në krahun e djathtë të rrejdhës së lumit Shkumbin, në afërsi të bregut të tij.



Për të akomoduar një linjë teknologjike me kapacitet të ulët, kërkohet një ndërtesë e veçantë me një sipërfaqe prej rreth 200 m². Në këtë godinë vijnë proceset ndërtimore si dhe instalimi i disa pajisjeve përfshi këtu edhe dhomën frigoriferike për mbajtjen e produktit që do të realizohet, garderobat dhe ambjentet hidro-sanitare për punonjësit, ambjentet për pajisjet dhe personelin që do merret me mirëmbajtjen e shërbimet teknike të pajisjeve, rrjetet e kanalizimeve për mbledhjen e ujërave që dalin nga pasijet dhe ambjentet e punës, rreshjet atmosferike, vaskën e dekantimit, etj.

Objekti është i lidhur me rrugën automobilistike kombëtare Elbasan – Librazhd, me anë të një segmenti rrugor me gjatësi rreth 350-400 m. Ky segment rrugor është në procesin e rikonstruksionit, të trasesë së rrugës, kanaleve kullues, vendosjes së turbinave e sinjalistikës rrugore përfshi këtu edhe sistemin e ndriçimit.

Objekti gjendet relativisht larg qendrave të banuara të fshatrave Mengël, në perëndim të tij dhe të fshatit Labinot Fushë në lindje të tij. Kemi të bëjmë me një zonë tërësisht rurale në të cilën mungojnë jo vetëm shtëpitë e banimit por, edhe objekte të tjerë, si psh. të linjave prodhuese, objekte sociale e të shërbimeve, etj.

Kjo zonë/rajon mund të kategorizohet e pa ndotur nga veprimtari prodhuese e tregtare.

V. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis.

5.1. Shkarkime në ajër.

Gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarije janë identifikuar dhe vlerësuar shkarkime të gazeve dhe aromave në ajër, të cilat janë rezultat i:

a). Punës së kaldajës për ngrohjen e ujit që përdoret gjatë kryerjes së porçeseve të ndryshme teknologjike. Kaldaja e instaluar këtu, punon me gaz të lëngëzuar të naftës (G.L.N.). G.L.N. përbëhet kryesisht nga gazi butan CH₄H₁₀ (CH₃-CH₂- CH₂-CH₃) dhe gazi propan C₃H₈ (CH₃- CH₂-CH₃). Nga djegia e këtij gazi, nga oxhaku i kaldajës shkarkohen në atmosferë gaze të tilla si:

- Monoksidi i karbonit CO;
- Gazi karbonik CO₂;
- Dioksidi i squfurit SO₂;
- Okside të azotit NO_x;
- etj.

b). Punës së mjeteve të transportit të lëndëve të para, produktit, mbetjeve të ngurta urbane si dhe personelit punonjës të këtij subjekti.

5.2. Shkarkime në tokë.

Literatura teknike e cila ka të bëjë me proceset teknologjike dhe pajisjet respektive në shërbim të këtyre proceseve, për prodhimin e miellit të peshkut, tregojnë se përpunimi i mbetjeve të peshqëve, karkalecave etj. bëhen përgjithësisht pa krijimin e mbeturinave teknologjike.

Nga zhvillimi i kësaj veprimtarije do të krijohen edhe mbetjet urbane që do të përbëhen kryesisht nga ambalazheve të ndryshëm kryesisht letra/kartona, plastikë, qelq etj. si dhe mbetje ushqimore nga personeli punonjës. Të gjitha këto materiale të konsideruara mbetje, do të hidhen në kazanët metalikë, që do të vendosen brenda territorit të këtij subjekti. Ato do largohen prej andej nga subjekti që merret me trajtimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Elbasan.

5.3. Shkarkime të ujërave të ndotur.

Shkarkimet e ujërave të ndotur që do të dalin :

- gjatë proceseve të përpunimit të lëndës së parë për prodhimin e miellit të peshkut
- gjatë larjes së pajisjeve dhe ambienteve të punës.

Njëkohësisht do të kemi edhe shkarkimet e ujërave të zeza.

Ujërat e ndotur do të kalojnë nëpër disa pajisje pastrimi, të cilat janë në fazën e instalimit të tyre, përfshi këtu edhe një vaskë dekantimi e cila është duke u ndërtuar.



VI. Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme.

6.1. Puna e kaldajës.

Kaldaja për krijimin e avullit që do të marrë pjesë në proceset e prodhimit të miellit të peshkut, punon me gaz të lëngëzuar të naftës (GLN), një lëndë djegëse me tregues cilësor mjaft të mirë në raport me lëndë djegëse naftë, benzinë, solar e qymyr, që mund të ndeshen në kaldaja të tjera. Pajisjet e djegies së gazit, janë tërësisht të automatizuara, duke realizuar një proces djegie

të kontrolluar dhe për rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me shkarkime të pakontrolluara gazrash e tymrash nga oxhaku i kësaj kaldaje.

Është e rëndësishme të ushtrohet një kontroll periodik i vazhdueshëm, mbi gjendjen teknike të pajisjeve të djegies dhe të pajisjeve të tjera të kësaj kaldaje përfshi këtu edhe depozitën e GLN-së.

6.2. Impianti i pastrimit të ujërave të ndotur.

Pastrimi i ujërave të ndotur të cilët krijohen gjatë proceseve të ndryshme pune, është i lidhur i me faktorët dhe kërkesat mjedisore. Kapja dhe largimi i lëndëve të ngurta që mund të mbartin këto ujëra të ndotur rrit sasinë e mbetjeve të ngurta që shkojnë për rikuperim/riciklim në linjën përkatëse.

VII. Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur.

a). Zgjedhja e vendit.

Janë të njohura disa përparësi pozitive të cilat kanë influencuar në zgjedhjen e këtij vendi :

- Gjendja e këtij trualli, në një zonë rurale, larg qendrave të banuara, qendra rezidenciale, sociale, etj.
- Egzistenca e një fuqie punëtore dhe e një dëshire për angazhim në punë.

b). Zgjedhja e teknologjisë së prodhimit.

Subjekti "ROZAF" sh.p.k. ka zgjedhur një proces teknologjik dhe në vartësi të tij edhe një linjë teknologjike me pajisje bashkëkohore të cilat janë me efikasitet të lartë tekniko-ekonomike në vende Europjane.

VIII. Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme).

Literatura teknike e cila ka të bëjë me proceset teknologjike dhe pajisjet respektive në shërbim të këtyre proceseve, për prodhimin e miellit të peshkut, tregojnë se përpunimi i mbetjeve të peshqve, karkalecave, etj. bëhen përgjithësisht pa krijimin e mbeturinave teknologjike.

IX. Masat për përdorimin eficient të energjisë.

Skema teknologjike e përpunimit të mbetjeve teknologjike që dalin gjatë përpunimit për treg të peshkut, karkalecit të detit, etj. për prodhimin e miellit të peshkut të gatshëm për treg, ka një numër të kufizuar pajisjesh teknologjike.

Energjia elektrike si dhe energji të tjera, si psh. përdorimi i lëndëve djegëse GLN dhe naftë/benzinë, janë të kufizuar vetëm gjatë një dite pune 8 orëshe. Në përfundim të një turni

gjithçka do të jetë e mbyllur dhe për rrjedhojë nuk do të ketë asnjë lloj konsumi, vetëm energji elektrike për dhomën frigoriferike si dhe sistemin e ndriçimit jashtë godinave.

Pajisjet e instaluar janë bashkëkohore dhe me sisteme të automatizuara të konsumit të energjisë. Ato vihen në punë dhe ndalohen nga puna sa herë shihet e nevojshme nga punëtori që përdor ato.

X. Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Duke analizuar punën në linjën teknologjike të përpunimit të mbetjeve teknologjike që dalin gjatë përpunimit të peshkut, karkalecit të detit, etj. rezultojnë të dhëna se mund të bëjmë një klasifikim të mundësisë së rrishtit dhe ndodhjes së aksidenteve.

Risqet e mundëshme të pritëshme për këtë veprimtari përshkruhen në vijim:

- Mos zbatimi i grafikut të kontrolleve periodike mbi gjendjen teknike të kaldajës, të impjantit të depozitimit dhe shpërndarjes së G.L.N.-së, si dhe të pajisjeve të tjera të instaluar këtu.
- Mos zbatimi i grafikut të kontrolleve periodike mbi gjendjen teknike të pajisjeve ngritëse dhe të atyre transportuese.
- Mos kryerja korrekte e shërbimeve teknike të kaldajës, të impjantit të depozitimit dhe shpërndarjes së G.L.N.-së si dhe të pajisjeve të tjera të instaluar këtu.
- Mos kryerja korrekte e shërbimeve teknike të pajisjeve ngritëse dhe të atyre transportuese.
- Mungesë e furnizimit me energji elektrike, për periudha kohe të pacaktuara gjatë kohës së punës.
- Mundësia e rënies së zjarreve.

Niveli i rrishtit është relativisht i lartë nëse ndodhin zhvillimet e përshkruara në paragrafin paraardhës.

- i. Të gjitha zhvillimet e përshkruara në pikën **i** dhe **iv**, bëjnë të mundur punën jo normale të pajisjeve gjatë punës së tyre.

Nga puna jo normale e pajisjeve rritet rrishtit i ndërprerjes së pakontrolluar të shfrytëzimit të tyre si dhe rrishtit i dëmtimit të shëndetit të punonjësve që i shfrytëzon ato.

- ii. Pafatësia teknike apo neglizhenca, janë dy faktorë që bëjnë të mos zbatohen rregullat e përcaktuara në shfrytëzimin e çdo pajisje teknologjike të instaluar këtu.

Këto shkelje mund të shoqërohen ose jo me prishje të pajisjeve të veçanta të cilat i nxjerrin ato nga puna, rrishtin rrezikun e dëmtimit të personelit që i shfrytëzon ato, etj.

iii. Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike, nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta në zhvillimet e veprimtarive apo operacioneve të caktuara pune.

Pasojat vijnë për shkak të ndërprerjes së ndriçimit në ambjentet e brendëshme, ato të jashtme të punës, gjë që vështirëson apo pengon, kryerjen e kontrolleve të plota mbi punën e pajisjeve të caktuara, të cilat mund të bëhen shkak për aksidente në mjedis apo në sigurinë dhe shëndetin e punëtorit.

iv. Zjarret kanë shumë mundësi të ndodhin :

- Në impjantin e depozitimit dhe shpërndarjes së G.L.N.-së, në kaldajë, në vendet ku janë vendosur lëndët lehtësisht të djegëshme, si dhe në ambjentet ku gjenden mbetjet urbane.
- për shkak të keqfunksionimit të rrjetit të shpërndarjes së rrymës elektrike, nga mbingarkesat, prishje të izolacioneve, tokëzimeve, etj.

Rënia e zjarreve ndot mjedisin me produktet e djegies, nxehtësi duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e punonjësve. Në rastet ekstreme të eksplozioneve rreziku për shëndetin dhe jetën është shumë i madh.

Nga përshkrimi i argumentave të mësipërme si dhe të tjerë argumentash të përshkruar në kapitujt paraardhës të këtij dokumenti rezulton se zhvillimi i kësaj veprimtarije mund të klasifikohet me rrisht të moderuar apo të vlerësuar ambjental.

b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Subjekti është në fazën e kryerjes së investimeve për ndërtimin e plotë të kësaj veprimtarije, duke kuptuar këtu përfundimin e proceseve ndërtimore, atë të instalimit të makinerive e pajisjeve, të përfundimit të punimeve për sistemin e pastrimit të ujërave të ndotur, segmentin rrugor për lidhjen me rrugën automobilistike kombëtare, etj.

Gjithësesi, në përgjigje të kërkesave të kësaj rubrike, duke shqyrtuar me kujdes faktorët pozitivë dhe ato negativë që mund të lindin nga mbyllja e kësaj veprimtarije, mund të pohojmë se janë të domosdoshme të kryhen këto procedura:

- Largimi i të gjithë sasive të lëndës së parë (mbetjeve teknologjike nga përpunimi i peshkut, karkalecave të detit, etj.), produktit të realizuar (miellit të peshkut), që gjenden këtu në momentin e ndërprerjes së aktivitetit.
- Çmontimin e pajisjeve dhe makinerive, pastrimin e tyre nga të gjitha lëndët që ato mund të jenë ndotur.
- Shitjen e këtyre pajisjeve subjekteve të interesuara për to apo, shitjen si skrap metalik.
- Pastrimin e objektit nga të gjitha llojet e mbetjeve të ngurta dhe të lëngëta duke u kujdesur për një ndarje selektive prej tyre të materialeve që mund të riciklohen. Kështu

mbetjet metalike, plastike, të letrës dhe kartonave, etj. duhet të shkojnë në subjekte që merren me riciklimin e tyre.

- Lyerjen dhe dezinfektimin e të gjithë ambjenteve të brendëshme dhe të atyre të jashtme të godinave egzistuese.
- Shkëputjen e lidhjeve nga rrjetet inxhinjerie të furnizimit me energji elektrike dhe ujë.
- Dorëzimi në organet e përcaktuara ligjore, të të gjithë leje dhe liçensave për ushtrimin e këtij aktiviteti.

XI. Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Numri referues i pikës së shkarkimit: A-1

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve	Metoda e marrjes së mostrave	Metoda/teknika e analizës
Okside azoti si (NO ₂)	Çdo 6 muaj	oxhakun e kaldajës	Nuk merret mostër.	Sipas standartit përkatës
Oksid karboni si (CO)	Çdo 6 muaj	oxhakun e kaldajës	Nuk merret mostër.	Sipas standartit përkatës

Numri referues i pikës së shkarkimit: B-1

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Aksesi në vendodhjet e matjeve	Metoda e marrjes së mostrave	Metoda/teknika e analizës
pH	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës
Lëndët në pezulli.	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës
BOD ₅	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës
COD	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës
Vajërat bimore	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës
Nitrati total	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës
Fosfori total	Çdo 6 muaj	ujërat që shkarkojnë nga vaska e dekantimit.	Sipas standartit përkatës	Sipas standartit përkatës

Informacioni i mësipërm duhet të përfshihet në **Aneksin 14**.